# DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

DPSHTRR

# TAKSA VJETORE E MJETEVE

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë

**Pronari i Mjetit:**

**NID/NIPT:**

**Targa:**

**Lloji i Mjetit** : Autoveturë

**Viti i Prodhimit:** 2007

| Përshkrimi | Viti | Vlera |
|---|---|---|
| Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura(TVMP) | 2025 | 15,043 |
| TVMP-Gjoba | 2025 | 0 |
| Taksa Vjetore e Mjeteve të Luksit (TVML) | 2025 | |
| TVML-Gjoba | 2025 | |
| TRML-Taksa e Regjistrimit të Mjeteve të Luksit | 2025 | |
| Detyrime të Prapambetura | | 0 |
| TOTAL | | **15,043** |

Portali eAlbania

| Klienti | Arkëtari |
|---|---|
| Taksat vjetore të paguara në: | 29/09/2025 |
| E vlefshme për qarkullim deri në: | 29/09/2026 |

**Shënim**: Taksat e paguara sipas kësaj fature i përkasin vitit kalendarik *!

**Kujdes!** Në rast të çregjistrimit të mjetit në vitin pasardhës, paguhen taksat për periudhën 1 janar deri dhe përfshirë muajin e çregjistrimit! Në rast të rifutjes së mjetit në qarkullim, paguhen taksat për periudhën nga dhe përfshirë muajin e rifutjes në qarkullim deri në fund të vitit!
Nuk aplikohen penalitete për periudhën e 365 ditëve nga data e pagesës së taksave të mjetit!

## PULLA E TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PERDORURA

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

# 2025

*Viti kalendarik

**Targa** **Nr.**

| | |
|---|---|
| Taksa vjetore të paguara në/Annual taxes are paid on | 29/09/2025 |
| E vlefshme pë qarkullim deri në/Valid to circulate until | 29/09/2026 |
| Taksat e vitit pasardhës paguhen në / The upcoming annual taxes due on | 29/09/2026 |

## TAKSAT VJETORE TË MJETIT

### Si llogaritet Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura (TVMP)?

Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura (TVMP) është e vlefshme për 365 ditë dhe llogaritet sipas formulës: Cilindrata në cm3 x Koeficienti i Vjetërsisë x Koeficienti i Karburantit Të dhënat e koeficientëve i gjeni në: www.dpshtrr.gov.al

### Çfarë konsiderohet automjet luksoz dhe cilat janë taksat shtesë që paguhen për këto mjete?

"Automjet luksoz" konsiderohet autovetura deri në 6+1 vende, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

- cilindratën e barabartë ose më të madhe se 3,000 cm3 ose
- vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5,000,000 lekë.

DPSHTRR, për përcaktimin e vlerës së mjetit, kur regjistrohet për herë të parë ose kur ndryshon pronësinë e tij, merr vlerën/çmimin më të lartë nga dokumentacioni financiar shoqërues i mjetit. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit "Automjet Luksoz", reduktohet çdo vit me 10% të vlerës së mbetur.Krahas taksës vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP), për automjetet luksoze paguhet taksa e regjistrimit për mjetet e luksit për herë të parë (TRML) në masën 70,000 lekë dhe Taksa Vjetore e Mjeteve Luksoze (TVML) në masën 21,000 lekë.

### Ku mund t'i paguaj taksat e mjetit?

DPSHTRR mundëson shërbimin për pagesën e taksave të mjetit në sportelet e drejtorive rajonale, zyrat e shërbimit dhe përmes pagesës online në portalin e-Albania.

### Do regjistroj një mjet për herë të parë. Si llogaritet vlera e taksës?

Në rast se do të regjistroni një mjet për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, taksat e mjetit do të llogariten nga muaji i regjistrimit të mjetit deri në 31 dhjetor të vitit kur do regjistrohet. Pra, nëse mjeti do regjistrohet në datën 7 korrik, shuma e taksës do të përllogaritet nga muaji korrik deri në datën 31 dhjetor të atij viti. Në vitin pasardhës, taksa do të përllogaritet e plotë për 12 muaj.

### Dëshiroj të ndërroj pronësinë e mjetit/shes mjetin. Duhet të paguaj taksë?

Nëse mjetit do i ndryshohet pronësia (shitblerje, dhurim, etj.), mjeti duhet të jetë aktiv në sistem për kryerjen e procedurës dhe i lirë nga detyrimet në DPSHTRR (taksat, penalitete) dhe INTERPOL. Pra, mjeti duhet të ketë taksa të paguara ose të vlefshme për atë vit.

### A duhet t'i paguaj taksat e mjetit para se të kryej kontrollin teknik?

Para se të kryeni shërbimin e kontrollit teknik, mjeti duhet të jetë i lirë nga të gjitha detyrimet në DPSHTRR (taksat, penalitete). Pra, mjeti duhet të ketë taksa të paguara ose të vlefshme për atë vit.

### Po nëse afati i vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit Teknik për mjetin tim është 2-vjeçar, a duhet t'i paguaj taksat e mjetit?

Po, taksat e mjetit [illegible] pavarësisht se afati i vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit Teknik [illegible] si në rastin tuaj, 2-vjeçare, ju duhet të shlyeni detyrimin e taksës [illegible] afatin e përcaktuar të vlefshmërisë së taksës.

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë
Date:2025/09/29 09:48:01 +02'00'
f330f23ecf34425c865acc540dfc7ff
d202509290947527301005

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë)

### Dua të çregjistroj mjetin. Sa do jetë vlera e taksës?

- **Çregjistrim i përkohshëm**

  Në rast se do çregjistroni mjetin përkohësisht, ju duhet të shlyeni të gjitha detyrimet e mjeti në DPSHTRR (taksa, penalitete) në raport me periudhën që mjeti ka qarkulluar, pavarësisht afatit të vlefshmërisë. Pra, nëse mjeti do çregjistrohet në korrik, taksa do përllogaritet si vlerë nga janari deri në korrik.
  Nëse ju do ta riaktivizoni sërish në sistem mjetin, ju do të paguani nga muaji i rifutjes në qarkullim deri në 31 dhjetor të atij viti. Pra, nëse mjeti do rifutjes së mjetit në qarkullim në tetor, taksa do përllogaritet si vlerë nga muaji tetor deri në 31 dhjetor.
  Gjatë periudhës që mjeti do qëndrojë i çregjistruar, nuk ka taksa vjetore.
  DPSHTRR administron dhe ruan dokumentet dhe targat e mjetit pa kosto për një periudhë 5-vjeçare. Pas kësaj periudhe, do të llogaritet një tarifë për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit dhe të targave.

- **Çregjistrim i përhershëm**

  Në rast se mjeti çregjistrohet në mënyrë të përhershme, zotëruesi i mjetit do të paguajë taksat dhe të gjitha detyrimet e tjera të atij viti në raport me periudhën që mjeti ka qarkulluar. Pra, nëse mjeti do çregjistrohet në korrik, taksa do përllogaritet si vlerë nga janari deri në korrik.
  Për procedurën e plotë të çregjistrimit, vizitoni: www.dpshtrr.gov.al

### A duhet të paguaj taksa nëse nuk do e përdor mjetin për disa kohë?

Nëse nuk do qarkulloni me mjetin për një kohë të gjatë, ju mund të bëni çregjistrimin e përkohshëm të mjetit duke mos paguar taksa për periudhën kur mjeti rezulton i çregjistruar përkohësisht. Para çregjistrimit të mjetit, ju duhet të keni shlyer të gjitha detyrimet e mjetit. Gjatë periudhës që mjeti do qëndrojë i çregjistruar, nuk llogariten detyrime.
**Vini re!** Ju nuk mund të qarkulloni me mjet të çregjistruar (joaktiv në sistem). Dorëzohen targat dhe dokumentet e mjetit për një afat administrimi nga DPSHTRR deri në 5 vjet. Pas këtij afati, do të llogaritet një tarifë për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit dhe të targave.

### Nëse mjeti që kam regjistruar është i ri (vjetërsi: 0-3 vjet), a duhet të paguaj taksa?

Nëse mjeti i regjistruar është i ri (vjetërsi: 0-3 vjet), mjeti përjashtohet nga pagesa e taksës. Për këto vite ai do të paguajë vetëm tarifën e shërbimit në shumën prej 200 lekë me TVSH.

### Përfiton nga taksat një invalid dhe a duhet të dorëzoj ndonjë dokument?

Po, invalidët, veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuara që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse që zotërojnë dhe përdorin për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private autovetura tip deri në 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2,500 kubikë përjashtohen nga pagesa e taksës. Për çdo vit ata do të paguajnë vetëm tarifën e shërbimit në shumën prej 200 lekë me TVSH.

Për informacione më të detajuara: www.dpshtrr.gov.al